

TREES FOR LURË

Organizatë jo-qeveritare jo-fitimprurëse e themeluar në
2019 me mision ripyllëzimin e zonave të dëmtuara të
Parkut Kombëtar Lurë-Mali i Dejës

RRETH NESH

TREES FOR LURË ËSHTË NJË ORGANIZATË JO-QEVERITARE, JO-FITIMPRURËSE E THEMELUAR NË VITIN 2019, ME MISION RIPYLLËZIMIN E ZONAVE MË TË DËMTUARA TË PARKUT KOMBËTAR "LURË-MALI I DEJËS". AJO OPERON NË DY PROJEKTE KRYESORE TË CILËT REALIZOJNË NË MËNYRË TË QËNDRUESHME RIPYLLËZIMIN BRENDA PARKUT KOMBËTAR.

PROJEKTI I RIPYLLËZIMIT REALIZOHET **90% NGA EKIPI VENDAS**, PUNËTORË TË CILËT JETOJNË NË LURË TË VJETËR, FUSHË-LURË, BORIE-LURË, GUR-LURË ETJ. VULLNETARËT, PARTNERËT DHE SHKOLLAT FTOHEN ZAKONISHT VETËM GJATË FUNDJAVAVE PËR TË MBJELLË SIMBOLIKISHT 10% TË MBETUR TË FIDANËVE. KY PROJEKT NDAHET NË DY FAZA PUNE, FAZA E PARË KA TË BËJË ME PËRGATITJEN E TERRENIT, HAPJA E GROPAVE ME DIMENSIONE DHE PA SKEMË SIPAS MIRATIMIT TË PROJEKTIT NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE - AKZM DHE ADZM DIBËR; SI DHE FAZA E DYTË KU MBILLEN FIDANËT. EKIPI I PUNËTORËVE PËRBËHET NGA RRETH **60% BURRA DHE 40% GRA**, KU ZAKONISHT FAMILJE TË TËRA MARRIN PJESË GJATË OPERACIONEVE TË MBJELLJES.

FIDANISHTJA E TREES FOR LURË NDODHET NË FUSHË-LURË NË KUOTËN **1,100M MBI NIVELIN E DETIT** DHE KA KAPACITET PRODHUES **20,000 FIDANË NË VIT**. AJO OFRON MUNDËSI SHITESË PËR KRIJIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR KOMUNITETIN VENDAS.

NË FIDANISHTE AKTUALISHT RRITEN **PISHË E ZEZË** (PINUS NIGRA), **ARNEN** (PINUS PEUCE) DHE **BREDH** (ABIES ALBA), FARAT E TË CILËVE JANË MBLEDHUR NË VITET 2021-2022 BRENDA PARKUT KOMBËTAR "LURË-MALI I DEJËS".

FIDANËT QË RRITEN NË KËTË FIDANISHTE JANË AUTENTIKË DHE PËRBËJNË KATEGORINË E FIDANËVE MË TË PËRSHTASHËM PËR T'U MBJELLË NË KËTË PARK KOMBËTAR.

**Nëse ke ndonjë pyetje, sugjerim apo thjesht do të na përshëndesës...
na shkruaj në Instagram, Facebook, ose në e-mail
hello@treesforlure.org**

Na kontakto!



Ekipi: Pavel Kunc, Anisa (Kulla) Coniku, Ersan Karameto, Joreld Dharmo, Mirjana Pali, Olgerta Puta, Gentjana Lasku

2021 - 2023 FAKTE KYÇE



KEMI MBJELLË 22 793 FIDANË NË
NJË SIPËRFAÇE PREJ 15.22 HA

% E MBIJETUESHMËRISË
81.33% (2021-2022)

€30,834
KONTRIBUT NË
KOMUNITET

KOMUNITETI

	Punëtorë	Gra	Të rinj	Vullnetarë
2021	8	2	1	45
2022	29	11	3	32
2023	35	14	6	47

KOSTO
PËR
1 FIDAN



KOSTO FIDANI = €0.6

KOSTO TË MBJELLJES = €1.43

KOSTO TOTALE = €2.03

RIPYLLËZIMI

Numri i fidanëve

22,793 fidanë

Sipërfaqe e ripyllëzuar


15.22 ha

Komuniteti i përfshirë

35 persona/14 gra

Kohëzgjatja

2021-2023



PËRQINDJA E MBIJETUESHMËRISË 81.33% (2021-2022)

Fokusi ynë kryesor është ripyllëzimi dhe rehabilitimi i 500ha pyje të dëmtuara në Parkun Kombëtar "Lurë-Mali i Dejës". Mbështjetja tek komuniteti vendas është thelbësore për të arritur objektivat tonë, gjë që krijon një marrëdhënie të fortë mes komunitetit dhe projekteve tona, duke na lejuar të kontribuojmë në mënyrë domethënëse edhe në ekonominë lokale. Kjo qasje është e ndryshme nga organizata të tjera të cilat kanë operuar apo operojnë në fushën e ripyllëzimit, e për pasojë edhe ka pritshmëri më të larta për arritjen e rezultateve afatgjata.



FIDANISHTJA

Numri i fidanëve/Kapaciteti

10,061 /20,000 fidanë

Llojet e fidanëve

Pinus nigra, Pinus Peuce*, Abies alba

Vendodhja

1,100 m mbi nivelin e detit

Kohëzgjatja

2022-2023



TEKNOLOGJIA DHE RIPYLLËZIMI

sistemi jonë i monitorimit mat nivelet e lagështisë së dheut, temperaturës, nivelet e ndriçimit, sistemi i karikimit të baterisë përmes panelit diellor etj.

Fidanishtja është një ndër elementët më të rëndësishëm e cila na ndihmon për të përmbushur objektivat tonë të ripyllëzimit, si dhe siguron prodhim në mënyrë të qëndrueshme të fidanëve.

Fidanët e rritur nga fara e mbledhur në Parkun Kombëtar janë autentikë dhe përbëjnë kategorinë e fidanëve më të përshtashëm për t'u mbjellë brenda në këtë park. E vendosur në kuotën 1,100 m mbi nivelin e detit, përbën një nga fidanishtet më të veçanta të Gadishullit të Ballkanit.



*Arnen (*Pinus peuce*) specie në zhdukje

KOMUNITETI

Përfshirja

35 persona/14 gra

Aktivite me shkolla

3 (43 nxënës)

Kontributi në komunitet

19 familje të punësuar

Impakti ekonomik (2021-2023)

€30,834



Nga 8 të punësuar (2021)
në 35 të punësuar (2023)

Një nga qëllimet kryesore të projektit të ripyllëzimit në Lurë është përfshirja e komunitetit vendas duke u ofruar atyre punë sezonale si dhe duke inkurajuar/promovuar barazinë gjinore duke punuar me gratë.

Projektet tona të ripyllëzimit dhe fidanishtes mbështeten kryesisht tek komuniteti vendas. Vullnetarët që angazhojmë në këto projekte janë shkollat dhe universitetet, duke sjellë nxënës/studentë në Lurë për të mësuar më tepër mbi të gjitha fazat e ripyllëzimit.



PARTNERËT

JEMI KRENARË QË PUNOJMË ME PARTNERË QË MBËSHTESIN MISIONIN TONË PËR TË MBJELLË PEMË, DUKE MBËSHTETUR GJITHASHTU KOMUNITETIN VENDAS SI DHE DUKE REALIZUAR PROJEKTE TË QËNDRUESHME DHE AFATGJATË RIPYLLËZIMI. BASHKËPUNIMI MUND TË BËHET NË MËNYRA TË NDRYSHME, ME DONACIONE FINANCIARE APO ME PARTNERITET DHE BASHKËPUNIM MË AFATGJATË. NËSE JENI TË INTERESUAR TË BASHKËPUNONI, MOS HEZITONI TË NA KONTAKTONI.

risr/

€30,113

RISR/, MË PARË E QUAJTUR FRY-IT, LTD., ËSHTË NJË KOMPLANI NË MBRETËRINË E BASHKUAR, E CILA OFRON SISTEME TË PROVIMEVE MJEKËSORE ON-LINE PËR UNIVERSITETE NË EUROPE, KANADA, AUSTRALI DHE ZELANDËN E RE. RISR/ NA MBËSHTET ÇDO VIT, QË PREJ VITIT 2021, SI PJESË E INVESTIMIT TË TYRE NË MJEDIS DHE QËNDRUESHMËRI.



ONETREEPLANTED

\$10,000

ONE TREE PLANTED ËSHTË NJË ORGANIZATË JO-FITIMPRURËSE GLOBALE, ME BAZË NË SHBA, ME MISION LEHTËSIMIN E RRUGËS PËR KËDO QË DO TË NDIHMOJË MJEDISIN DUKE MBJELLË PEMË. BASHKËPUNOJMË QË PREJ VITIT 2023 DHE ONE TREE PLANTED NA MBËSHTET DUKE FINANCIAR \$1 PËR ÇDO FIDAN QË NE MBJELIM.



€10,000

BESTSELLER ËSHTË PRODHUESI DHE SHITËSI MË I MADH I MOBILJEVE NË SHQIPËRI. BASHKËPUNOJMË QË PREJ VITIT 2023 DHE BESTSELLER ËSHTË I ANGASHUAR PËR TË MBËSHTETUR NË MËNYRË AFATGJATË PROJEKTET TONA TË RIPYLLËZIMIT DHE FIDANISHTES. PËRVEÇ MBËSHTETJES FINANCIARE, BESTSELLER PROMOVON NË MËNYRË AKTIVE PROJEKTET TONA NË FAQEN E TYRE ZYRTARE SI DHE NË RRJETET SOCIALE.



Shirt-King

€9,575

HELDENWERBUNG GMBH (SHIRT-KING, BUTTON.KING) ME QENDËR NË BERLIN, GJERMANI ËSHTË PRODHUES DHE SHITËSI I T-SHIRTS DHE ARTIKUJVE TË TJERË PROMOCIONALË ME CILËSI TË LARTË. BASHKËPUNOJMË QË PREJ VITIT 2022, DUKE NA DHURUAR 1 PEMË PËR ÇDO POROSI QË MARRIN NË DY FAQET E TYRE TË INTERNETIT SHIRT-KING.DE DHE BUTTON.KING.DE.



Materiale për fidanishten

KOMPANI ME NJË EKSPERIENCË TË GJATË NË FUSHËN E PRODHIMIT TË MATERIALEVE PLASTIKE, SJELL TEK JU GARANCINË DHE SIGURINË MAKSIMALE TË PRODHIMIT PËRMES PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE DHE STAFIT PROFESIONAL. BASHKËPUNOJMË QË PREJ VITIT 2022, DUKE NA OFRUAR PLASTIKË PËR TË VESHUR/RIPARUAR SERËN TONË.



innospace™

Hapësirë zyre

NJË AMBIENT PUNE KREATIV NË ZEMËR TË BLOKUT, ME NJË HAPËSIRË FUNKSIONALE DHE MODERNE, KU MUND TË FOKUSOHENI NË PROJEKTET TUAJ TË ARDHSHËM. BASHKËPUNOJMË QË PREJ VITIT 2023 DHE ATA NA MBËSHTESIN DUKE NA OFRUAR FALAS HAPËSIRË ZYRE PËR TAKIMET TONA TË EKIPIT NË TIRANË.



**DO TË BËHESH PARTNER?
Na kontakto!**

Vizitoni treesforlure.org për më tepër



Qendra "Trees for Lurë"
Rr. Pjetër Bogdani, Nd 10, H 5, Apt 28, 7th Floor,
1019, Tiranë, Albania

NIPT: M02208452W

+355 68 822 5132
hello@treesforlure.org
treesforlure.org